

SHOQERIA TREGTARE ME ORTAKERI
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

”GASTRONOMI”SH P K

DURRES - SHQIPERI

AKT THEMELIMI

Ne Durres, sot me daten **03.03.2023**, (dymije e njezetetre) dite e premte, une Z.Elvin Kuraja:

1. Shtetasi **Z. Elvin Kuraja**, atesia Vlash, amesia Violeta, i datelindjes 24.11.1975, shtetas shqipetar, lindur ne Durres, dhe banues ne Lagjjen nr.12, Rr. “Marta Buda” Pallat Durres, Cel.: 0672660999, identitet qe provohet me *Karten e identitetit ID H51124039A*: bazuar ne:

- * Vullnetin tim te lire, te plote, te sinqerte dhe ne inisiativen e lire private,
- * Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,
- * Ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”,
- * Ne Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”
- * Ne Ligjin Nr.7764 date 02.11.1993 “Per Investimet e huaja” dhe ne te Drejten nderkombetare Publikedhe Konventat nderkombetare te gjithhepranuara te **Komunitetit Europian**, me anen te ketij **Akti Themelimi**, krijojme **Shoqerine tregtare me ortakeri** dhe me pergjegjesi te kufizuar “**GASTRONOMI**” Shpk.

NENI 1

Krijohet Shoqeria tregtare me emrin “**GASTRONOMI**” Shpk.
emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia Qendrore e Shoqerise eshte ne adresen: Lagjja nr. 14, Rruga Adria, Objekt me nr. pasurie 5/2732-N2, Zona Kadastrale 8515, Durres.

NENI 3

Shoqeria shtrin aktivitetin e saj tregetar ne te gjithë juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve mund te krijohen ose anulohen (ne rast se jane çelur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise,apo ne ndonje shtet tjeter te huaj.

Njesite e tjera strukturore te shoqerise, si dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit, krijohen kur nje gje te tille e parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve te huaja normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte ne likuditet ne shumen 100.000 Lekë (njqindemije) Lekë. I gjithë kapitali zoterohet nga ortaku i vetem themelues **Z.Elvin Kuraja**. Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 1 (nje)kuote e barabarte me shumen 100,000 leke (njqind mije leke) dhe i perbere nga **kontribute ne cash** te ortakut themelues ne shumen 100,000 leke.

Ortaket kane pavaresi ligjore, organizative si dhe te drejta pronesie mbi çdo lloj Kapitali, mjete xhiroje apo çdo lloj pasurie tjeter (te luajteshme apo te paluajteshme), te fituar ne rruge te ligjeshme.

Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

Ortaket kane te drejte te transferojne jashte territorit te Republikes se Shqiperise pjeserisht ose teresisht kontributet e tyre, perfshire fondet dhe vlerat e kontributit ne NATYRE bazuar ne te drejten qe u njeh Ligji "Per Investimet e Huaja".

Shoqeria dhe te tretet, respektojne keto Transferime sapo tu behen te ditura.

NENI 5

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve, ne dispozicion te Shoqerise mund te vihen fonde te tjera duke perfshire dhe shtesa me ane te kapitalit ne natyre

NENI 6

Ortaket kane te drejte, qe pas shlyerjes se detyrimeve ndaj te treteve, detyrimeve ligjore te Sistemit te taksave dhe atij fiskal dhe ruajtjes se Fondit Rezerve.

NENI 7

Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj tregetar ne keto Drejtime:

Prodhimi dhe përpunimi i mishit dhe produkteve me baze mishi.Tregtia me shumicë dhe pakice e mishit dhe produkteve të mishit. Import eksport artikuj ushqimore, pijeve dhe duhanit ,produkte shtazore , mish dhe nenproduktet e mishit , peshku dhe nenproduktet e peshkut. Agroturizem, ndertim struktura hotelerie dhe ferma. Kultivim peshku ne ujera te embla.

Ndërtime civile,industriale e monumentale mbi dhe nën tokë me konstruksion betoni,çimento,hekuri,druri,etj;Restaurime ndërtesash;Marrja e përfaqësisë në fushën e ndërtimit për vete e të tretë,publik ose privat,brenda dhe jashtë vendit;Projektim dhe zbatim punimesh ndërtimi;Dizenjim urbanistik;Konsultim në aktivitetet e ndërtimit.Gërmime dheu;Prishje ndërtimesh;Shtrim i sipërfaqeve me materiale speciale përfshirë edhe rrugët publike;Pastrim në ambiente publike e private;Punime në gjelbërim dhe kopshtari;Izolime;Instalim impiante elektrike,hidraulike,telefoni,internet e teknologji e avancuar e transmetimit; Impiante teknologjike;Vepra të inxhinierisë së natyrës;Aparatura strukturore speciale;Barriera dhe mbrojtëse rrugore;Struktura të parafabrikuara prej betoni;Impiante për përpunimin dhe rekuperimin e mbeturinave;Pastrim të sipërfaqeve ujore,detare,liqenore,lumore;Komponente strukturore me përbërje hekuri e metali;Matje topografike;Impiante depurimi dhe bonifikimi;Gërmime arkeologjike;Impiante termike e të

kondicionimit; Sisteme kundra zhurmës dhe për infrastrukturën e pajisjeve të lëvizshme; Rikonstruktime; Lotizime; Montim, zmontim të strukturave, skelave dhe platformave të punës si dhe dhënie me qira e tyre; Marrja e të drejtës ose konçensionit, shfrytëzimi i materialeve të argjilës, rërës, tokës e materialeve të tjera. Import-eksport, tregti, përdorimi vetjak ose dhënia me qira e mjeteve dhe makinerive të ndërtimit, vinça, eskavator, buldozier, rampa, makineri përzierëse, pompa llaçi, etj. Ndërtimi dhe menaxhimi i kantierëve, stabilimenteve, ofiçinave, impianteve, magazinave, etj. Furnizimi dhe instalimi i aparaturave ngritëse, xhiruese dhe shërbyese në ndërtim, teleferik, etj. Prodhim dhe tregtim i materiale të ndërtimit e të gjitha nëndegëzimet e tyre edhe nëpërmjet riciklimit. Kryerja e veprimtarisë në realizimin dhe montimin e impianteve elektrike të tensionit të ulët-mesëm-lartë, centrale, kabina transformacioni, ndriçim publik, etj. Shërbime të leximit dhe matjes së konsumit të energjisë, ujit, gazit, etj. Marrja e liçensave të ndryshme në çdo aktivitet të ndërtimit apo lëndës së ndërtimit. Përfitimi, shitja, shkëmbimi, ndërtimi, qiradhënia e terreneve dhe fabrikateve, marrja në tituj e pasurive të paluajtshme edhe me leasing, përfshirë përdorimin. Import-Eksport dhe tregtimi me shumicë ose pakicë i materialeve të ndërtimit, mjeteve motorike të reja ose të përdorura që përdoren në ndërtim apo në industri të tjera të biznesit, pjesë këmbimi për to, makinerive të përdorshme në ndërtim dhe tregtimi apo dhënia me qira apo tituj të tjerë tek të tretët; Shërbimi mirëmbajtjes dhe pjesë këmbimi për këto mjete motorike dhe makineri; import-eksport dhe tregtimi me shumicë ose pakicë i mallrave të përgjithshme pakufizim që kërkohen në tregun e lirë. Tregtim me pakicë i karburantit dhe nënprodukteve të tij, aq sa lejohet nga forma juridike e shoqërisë. Përdorim direkt ose indirekt i veprave të ndërtuara ose të blera të impianteve e të shërbimeve të tyre; Shit-blerje, marrje me qira, shkëmbim, mirëmbajtje, shkatërrim, administrim për llogari personale ose të tretëve e të mirave komerciale, industriale, artizanale, sociale, rurale, terrene bujqësore dhe truall ndërtimi, qiradhënie e nënqiradhënie, duke përfshirë të gjitha aktivitetet e përfshira me ndërtimin. Shërbime të lidhura me aktivitetin e projektimit arkitektonik e inxhinierik, me përjashtim të aktiviteteve që për nga ligji i rezervohen të regjistruarve në regjistra profesionale. Për përmbushjen e qëllimit të veprimtarisë shoqëria mund të zhvillojë të gjitha operacionet tregtare, industriale, mobiliare, mbi sendet e përdorimit, të japë garanci edhe për të tretët, të jetë pjesëmarrëse në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm ose të përafërt, në respektim të normave ligjore në fuqi. Ndërtim struktura për prodhim energjie. Prodhim tregtim dhe transmetim energjie. Janë të përjashtuara nga veprimtaria e shoqërisë aktivitetet që sipas ligjeve në fuqi ose akteve ndërkombëtare i rezervohen shoqërive të veçanta ose një forme tjetër juridike

- Marrjen pjesë në Panairë kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim jo vetëm ekspozimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë por dhe për të mundësuar arritjen e marrveshjeve kontraktore me persona juridik vendas dhe të huaj për zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit të perbashkët tregtar me to, krijimin e shoqërive të perbashkëta tregtare si vendase dhe të huaja, pjesëmarrje në Tendera brenda e jashtë vendit, që lidhen me realizimin e qëllimeve të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë.

NENI 8

Me qellim arritjen e objektivit te shoqerise, shoqeria mund te merret me gjithëçka qe ka lidhje me objektin e saj, duke permbushur te gjitha veprimet tregtare, per pasurite e paluajtshme dhe te luajtshme, financiare e bankare, edhe me veprime te zbuluara (perjashtuar mbledhjen e fitimit), duke pranuar pjesemarrjen ne fitim si dhe marrjen pjese ne shoqeri te tjera dhe sipermarrje me objekt veprimtarie analog, te ngjashem ose te lidhur me te, qofte direkt, qofte indirekt.

NENI 9

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve, Shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere, shtetas shqipetar apo te huaj, ose te bashkohet me nje Shoqeri tjetere tregtare si brenda vendit dhe jashte shtetit, te zgjeroj Objektin e veprimtarise se saj, te ndahet ne mirekuptim mes ortakeve ose ne rruge gjyqesore etj.

NENI 10

Organi me i larte Drejtues dhe i vetem Vendimor i Shoqerise eshte Mbledhja Asamblese se Ortakeve e cila ushtron te gjitha kompetencat qe i njeh **Ligji Nr.9901 dt.14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"**.

Ortaket mund t'ja delegojne kompetencat e tyre nje ose me shume Administratoreve te caktuar me vendim te Asamblese se Ortakeve ose dhe nje personi fizik shtetas shqipetar apo i huaj, mbi bazen e **Prokures te bere me akt noterial**.

NENI 11

Me Vendim me shkrim te Asamblese se **Ortakeve** caktohet, shkarkohet **Administratori Pergjithshem** brenda ose jashte bashkesise se Ortakerise si dhe **Eksperti Kontabel i Autorizuar**.

NENI 12

Administrator i Pergjithshem i Shoqerise, emerohet **Z. Elvin Kuraja**, atesia Vlash, amesia Violeta, shtetas shqipetar, lindur ne i datelindjes 24.11.1975, shtetas shqipetar, lindur ne Durres, banues ne Lagjjen nr.12, Rr. "Marta Buda" Pallat Durres, Cel.: 0672660999, identitet qe provohet me *Karten e identitetit ID H51124039A*

Bazuar ne **nenin 95 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"**, Administratori Pergjithshem **Z. Elvin Kuraja**, emerohet per nje **periudhe kohe 5 vjet deri me 03.03.2028**, me te drejte riperteritje.

NENI 13

Detajimi ne lidhje me problemet dhe administrimin e Kapitalit themeltar dhe te pjeseve nominative te tij, Transferimi, zmadhimi ose zvogelimi i Kapitalit, menyra e Drejtimit Administrativ te Shoqerise, ajo e mbajtjes se llogarive dhe te Bilancit financiar, zgjerimi i Shoqerise ose shnderimi i saj ne nje forme tjetere Shoqerie Tregtare, bashkimi me Shoqeri te tjera tregtare vendase apo te Huaja, ndarja apo menytrat e falimentimit te saj

dhe kalimit ne Likuidim etj, percaktohen ne menyre me te specifikuar ne Statutin e Shoqerise qe i bashkelidhet ketij Akti Themelimi.

NENI 14

Si rregull dhe pergjithsisht Ortaket drejtojne dhe zhvillojne aktivitetin tregetar te Shoqerise mbi bazen e mirekuptimit profesional dhe ligjor.

NENI 15

Ky Akt Themelimi u redaktua ne 2 ekzemplare ne gjuhen **shqipe**, me permbajtje e vlera te njejta juridike dhe pasi lexohet , kuptohet dhe miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i Shoqerise tregetare me ortakeri **"GASTRONOMI" Shpk**, nenshkruhet prej tij ne te gjithe ekzemplet duke vene emri, mbiemri dhe firma origjinale.

ORTAKET THEMELUES

TE SHOQERISE TREGTARE ME ORTAKERI " GASTRONOMI" Sh p k
Miratues te ketij Akti Themelimi

Shtetasi Shqipetar

Elvin Kuraja